



VENDIM
Nr. 48 Datë 23.06.2010

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVË PËR MODIFIKIMIN E LICENSËS
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË
AMAL SH.P.K ME SERI PV03K, NR.09 LESHUAR ME VENDIM TE
BORDIT TE KOMISIONEREVE TE ERE-S NR.18, DT.16.10.2003

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pika 2.3 e “Licensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike” si dhe nenet 10 dhe 15 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr.21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.06.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “AMAL” sh.p.k për ndryshimin e licensës Nr.09, Seria PV03K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.18, dt.16.10.2003 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit sic kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licensës me numër Nr.09, seri PV03K, lëshuar me Vendim të Bordit të Komisionereve të ERE-s nr.18, dt.16.10.2003, të mbajtur nga shoqëria AMAL sh.p.k.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtë

KRYETARI I ERE-S

BUJAR NEPRAVISHTA